**LIGJ**
**Nr. 107/2018**

# PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 9918, DATË 19.5.2008, "PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 55, pika 2, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:
"c) shërbimet e *roaming-ut* mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.12.2018

**Shpallur me dekretin nr.11049, datë 14.1.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**